

VENDIM
Nr. 5, datë 4.1.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË BULQIZË TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Bulqizë, të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 377 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Bulqizë
nr.1

Lidhja

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e arsimit	Në pronësi
18-22	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
48	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
49,50	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
51	Shërbim funeral	Në pronësi
52,61-65	Troje të lira dhe hapësira publike	Në përdorim
53-60	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
322,323	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
324,325	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive)	Në pronësi
66-73	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (truall dhe ndërtesë)	Në përdorim
356	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të bardha e të zeza	Në pronësi
328-354	Infrastrukturë vendore (rrugë vendore, lulishte, trotuar, sheshe)	Në pronësi